



BALLINA

LAJME ▾

VIDEO

BOTA

SPORT ▾

OPINION ▾

SHOWBIZ ▾

LIFESTYLE ▾

AUTO & TEK ▾

FUN ▾

ENGLISH ▾

Kërcënoi me armë zjarri një person në Mitrovicë, arrestohet 19 vjeçari



15/11/2022 09:40



Një person ishte kërcënuar me armë zjarri dje në Mitrovicë.

Lidhur me këtë rast, Policia e Kosovës njofton se është arrestuar si i dyshuar një 19- vjeçar, shkruan lajmi.net.

“Sipas deklaratës së ankuesit, thuhej se në rrugën “Dëshmorët e Kombit” në Mitrovicën e Jugut, ishte kanosur nga personi i dyshuar i cili kishte ekspozuar një armë dhe ishte larguar nga vendi i ngjarjes. Lidhur me rastin janë ndërmarrë veprime të nevojshme hetimore me ç’ rast është identifikuar dhe arrestuar personi i dyshuar D. S., 19 vjeçar, shtetas i Republikës së Kosovës. Nga i dyshuari është konfiskuar një armë e llojit pistoletë me dy fishke e cila dyshohet se është ekspozuar nga i dyshuari në veprën penale.”, thuhet në njoftimin e policisë.

Policia bëri të ditur se në bazë të hetimeve të para dyshohet se veprës penale të kanosjes t’i ketë paraprirë një zënkë ndërmjet të dyshuarit dhe ankuesit.

Të gjitha veprimet hetimore janë paraqitur tek prokurorit të rastit.

Rasti është iniciuar dhe është duke u hetuar për veprat penale ‘Kanosje’ dhe “ Armëmbajtje pa leje”. Pas intervistimit, me urdhër të prokurorit të rastit, i dyshuari është liruar për procedurë të rregullt./**Lajmi.net**/

LAJME TË FUNDIT



Kujdes në trafik, nga sot mund të gjobiteni...



City, Liverpool e Milan në garë për Okafor



Gjakovë: Dy femra rrihen mes vete, njëra dërgohet në mbajtje për 48 orë



Benjamin Pavard lë derën hapur për Milanin: Kam...

Artikuj të ngjashëm



November 15, 2022

Kujdes në trafik, nga sot mund të gjobiteni nëse s'keni të...



November 15, 2022

Gjakovë: Dy femra rrihen mes vete, njëra dërgohet në mbajtje për 48 orë



November 15, 2022

Vdes në motel një burrë nga Vushtrria




November 15, 2022

Konjfuca takohet me delegacionin nga Kongresi i SHBA-ve



November 15, 2022

Shkon në tetë miliardë popullsia botërore



November 15, 2022

Dyshohet se i vunë zjarrin katër veturave në Prishtinë në muajin...

lajmi.net

info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyrja nr. 5

Other Links

Fact-Checking Policy
Ethics Policy
Corrections Policy
Ownership & Funding Information
Editorial Team Information

RRJETET SOCIALE

